**VENDIM**
**Nr.58, datë 24.2.2000**

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE QË KRIJOHEN NGA TRANSFORMIMI I NDËRMARRJEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA NË SHOQËRI TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetëtore në shoqëri tregtare" ndryshuar me ligjin nr. 8067, datë 15.2.1996 dhe me ligjin nr. 8099, datë 28.3.1996, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Vlerësimi i kapitalit të shoqërive që krijohen nga transformimi në shoqëri tregtare i ndërmarrjeve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura do të bëhet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 20.3.1998 "Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**